



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së Kuvendit,

Duke marrë parasysh:

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948);

Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950);

Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) (1979);

Deklaratën e OKB-së për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas (1993);

Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim (1995);

Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (2000) dhe

Rezolutat përkatëse 1820 (2008), 1888 (2009), 1889 (2009) dhe 1960 (2010);

Rishikimin e zbatimit të Platformës për Veprim, Pekini Plus 15 (2010);

Iniciativën e Projektit të Grave për përfaqësim në Shërbimin Civil deri në 50 % deri në vitin 2050;

Si dhe konventat dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare për fuqizimin e gruas dhe barazinë gjinore;

Duke ritheksuar zotimet e përbashkëta që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet përkatëse të Kosovës për barazi pa dallime, ku barazia gjinore është vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore;

Duke ritheksuar barazinë themelore të grave dhe burrave në të gjitha angazhimet njerëzore dhe të drejtat e patjetërsueshme të të gjitha grave për jetë, liri dhe siguri personale;

Duke i theksuar përpjekjet e përbashkëta për zhvillim, meqë gratë përbëjnë gjysmën e popullatës së vendit dhe kanë përvoja të veçanta dhe të shumëllojshme;

Duke marrë parasysh se nisma e Sekretares së Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Hillary Clinton dhe Qendrës Woodrow Wilson për Projektin për Gratë në

Shërbimin Civil do të rrisë përfaqësimin e grave në vendimmarrje duke promovuar qeverisje të mirë dhe zhvillim të shoqërisë dhe vendit, dhe do krijojë ndikim pozitiv dhe afatgjatë për gjeneratat e ardhshme;

Të bindur që udhëheqja e grave në institucionet e legjislativit, gjyqësisë, ekzekutivit, biznesit, politikës dhe shoqërisë civile sjell të mira në familje, shoqëri, zhvillimin ekonomik dhe të demokracisë në vend dhe shton paqen dhe sigurinë globale;

Duke pas parasysh se miratimi i Parimeve të Prishtinës do ta bëjë Kosovën vend udhëheqës në rajon për trajtimin e çështjeve gjinore;

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 20 dhjetor 2012, miratoi këtë:

## **REZOLUTË**

### **Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: “Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas”, më 4-6 tetor 2012, në Prishtinë**

1. Kuvendi inkurajon angazhimin dhe vendosmërinë e institucioneve qendrore dhe lokale, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat për zbatimin e dispozitave kushtetuese, ligjit për barazi gjinore dhe ligjeve të tjera relevante dhe planeve shtetërore të veprimit në funksion të zbatimit të Parimeve të Prishtinës.
2. Zotohet të fuqizojë monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave për barazi gjinore, duke bërë plotësimin e legjislacionit ekzistues dhe politikave sociale për përmbushjen e Parimeve të Prishtinës.
3. Inkurajon Qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës që të nxisin dhe mbështetësin zbatimin e Parimeve të Prishtinës në nivel rajonal dhe global.
4. Inkurajon institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrim veprime konkrete dhe të vendosin partneritete me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare për të përmbushur objektivin e pjesëmarrjes së gruas në shërbimin civil deri në pesëdhjetë për qind deri në vitin 2050.
5. Rithekson që pengesat e të gjitha llojeve – politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore – në pjesëmarrjen e plotë të gruas në shoqëri duhet të eliminohen, në mënyrë që të sigurohen të drejtat e patjetërsueshme të gruas.

Nr. 04-R-09  
Prishtinë, më 20 dhjetor 2012

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Cc:

- Presidentes së Kosovës,
- Kryeministrit të Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.